



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.325/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit Vakati, me seli në Prizren ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Nasha Boshnjacka Koalicija (NBK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e papabazuar ankesa Anr.325/2025 e datës 03.02.2025, e parashtruar nga Koalicionit Vakati, me seli në Prizren, paraqitur kundër Subjektit Politik Nasha Boshnjacka Koalicija (NBK), me seli në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Koalicionin VAKAT- Qerim Bajrami, me të cilën pretendon se kanë bërë shkelje serioze të dinjitetit, moralit dhe njerëzorisë, të emrit dhe mbiemrit të tij, ku përmendet direkt në tekstin e Samir Zoraniqit, aktivisti i NBK-së (subjekti politik në zgjedhje). Më tutje në ankesë theksohet se Samir Zoranić, jeton dhe punon në Pejë, i njëjti rregullisht përkrahë, (foto me Osman Dzeudzeviqin, udhëheqësi i NASHE, subjekti në koalicion me NBK dhe kandidat me nr. 2, ku pretendon se atë fyerje e ka shkruar Samir Zoraniqit në rrjetet sociale " të ne jemi gjithë Zhupa" e cila qëndron që tri ditë si temë kryesore në atë grup në Facebook, e cila është shumë e lexuar nga ana e anëtarëve dhe vizituesve. Në vazhdim theksohet se poashtu është edhe përmbajtja fyese ku thotë se Qerim Bajrami dhelpër e vjetër dhe i vetëdijshëm që ndër vite me veprime dhe grabitjes (kapjes) së pozitës dhe foteles për veti dhe për rrethin e afërt me idetë e tij të decentralizimit, ai personalisht e ka shitur lire dhe mashtroji, dhe me këtë rast dhe nuk ka kredibilitet me disa premtime të zjarrta duke përkrahur këtë temë.

Poashtu ankuesi pretendon se këtë tekst Samir Zoraniqit e ka postuar edhe në PAP faqe tjera të Fc edhe si koment në postime të aktivistëve dhe kandidatëve tjerë në zgjedhje të NBK-së.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur kopjet e përmbajtjes fyese në Grupin e Fc, "të gjithë ne jemi Zhupa" dhe kopjen e fotos të autorit të përmbajtjes fyese me

Osman Dzugzeviqin, P.P i Koalicionit NBK , merr pjesë në Zgjedhjet e përgjithshme me nr. 121.

Më datë 03.02.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Nasha Boshnjacka Koalicija (NBK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 04.02.2025, Lidhur me ankesën e bërë nga Koalicioni Vakant kundër subjektit politik Naša Bošnjacka Koalicija (NBK), të njëjtit besojnë se ankesa është e pabazuar, juridikisht e paqëndrueshme dhe në kundërshtim me rregullat ligjore, prandaj kërkojnë refuzimin e saj. Andaj kërkojmë që PZAP ta refuzojë këtë ankesë si të pabazuar, ligjërisht të pambështetur dhe të parëndësishme për procesin zgjedhor.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik NBK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik Koalicioni Vakant, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.*

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtresë i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.325/2025 më datë 05.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.